

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	4 mënyra për të krijuar marrëdhënie profesionale me ndikim real në karrierë! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/4-menyra-per-te-krijuar-marredhenie-profesionale-me-ndikim-real-ne-karriere/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:48:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 08:53:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	47fcda75baeaf4c772cfce0ad132cb53b3c3cbf479923b49dd18aff74e1977f3
TEKSTI	4e7296eb30e49a0f1109287285c0124271473185166d943becd12dc7b719d1c9
PAMJA	2807f50ffb6d574d206b0a5d9e69922049c00a78cb1c1cc20be84f58e3fbf7dc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6c2e3e94a4fa7771e0a7f694df00a5e220152a903b8024c3f30de1ff50fd1007
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6c2e3e94a4fa7771e0a7f694df00a5e220152a903b8024c3f30de1ff50fd1007>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Lifestyle

4 mënyra për të krijuar marrëdhënie profesionale me ndikim real në karrierë!



Dorjana Lato

08 Shtator 2026



Të gjeshe një punë të nivelit fillestar është bërë gjithnjë e më e vështirë në një treg pune ku kompanitë po tregohen më të kujdesshme me punësimet. Për Gjeneratën Z, kësaj vështirësie i shtohet edhe një tjetër: krijimi i lidhjeve profesionale që mund t'i ndihmojnë të hedhin hapin e parë në karrierë.

Të dhënat e reja të LinkedIn, të bazuara në një anketë me më shumë se 18 mijë profesionistë, tregojnë se të rinjtë e kuptojnë rëndësinë e marrëdhënieve profesionale në një treg pune konkurrues, por nuk dinë domosdoshmërisht si t'i ndërtojnë ato.

Rreth 53% e profesionistëve të Gjeneratës Z thonë se nuk janë të sigurt se nga duhet të fillojnë për të krijuar një marrëdhënie profesionale, ndërsa 52% e kanë të vështirë t'i shndërrojnë kontaktet që kanë në lidhje reale.

Kory Kantenga, drejtues për ekonominë në LinkedIn për Amerikën, thotë se shumë punonjës të rinj dinë si t'i dërgojnë dikujt një kërkesë për t'u lidhur në rrjetet profesionale, por vështirësia fillon më pas: si shndërrohet ky kontakt virtual në një marrëdhënie të mirëfilltë?

Sipas tij, të rinjtë duhet të kuptojnë se krijimi i rrjetit profesional nuk është diçka që bëhet vetëm një herë për të siguruar punën e parë pas universitetit. Është një proces që vazhdon gjatë gjithë karrierës dhe një aftësi që duhet zhvilluar vazhdimisht.

Rëndësia e tij është e matshme. Të dhënat e LinkedIn tregojnë se në SHBA, kandidatët për punë që kanë një kontakt brenda kompanisë ku aplikojnë kanë shtatë herë më shumë gjasa të punësohen.

Kantenga sugjeron katër mënyra për të krijuar marrëdhënie profesionale që mund të kenë ndikim real në karrierë.

1. Mos u mjaftoni me “Connect”: komentoni dhe përfshihuni në rrjetet sociale

Një nga mënyrat më të zakonshme që përdorin të rinjtë është t'u dërgojnë mesazhe njerëzve që nuk i njohin, duke u kërkuar 10 apo 15 minuta nga koha e tyre për një bisedë.

Kjo strategji mund të funksionojë. Sipas LinkedIn, 83% e profesionistëve të brezit Millennial dhe Gjeneratës X thonë se janë të gatshëm të ndihmojnë dikë që ndodhet në fillimet e karrierës, edhe kur nuk e njohin personalisht.

Por jo të gjithë ndihen rehat duke kontaktuar drejtpërdrejt një të panjohur.

Një mënyrë më organike është të filloni duke ndërvepruar me përmbajtjen që publikon personi me të cilin dëshironi të krijoni kontakt. Komentoni, pëlqeni postimet dhe bëhuni pjesë e grupeve apo komuniteteve profesionale që lidhen me fushën tuaj.

Vetëm anëtarësimi në një komunitet nuk mjafton. Duhet të ndani mendimet tuaja dhe të merrni pjesë në diskutime.

Në këtë mënyrë, personi tjetër jo vetëm kupton se e ndiqni punën e tij, por sheh edhe se keni këndvështrime, njohuri apo ide që mund t'i shtojnë vlerë një bisede profesionale.

2. Mos kërkonti të krijoni kontakte vetëm me drejtuesit

Kur ndërtojnë rrjetin profesional, shumë të rinj mendojnë se sa më i lartë të jetë pozicioni i një kontakti, aq më e vlefshme është lidhja.

Por kjo mund të jetë një qasje e gabuar.

Kantenga këshillon studentët dhe profesionistët në fillimet e karrierës të ndërtojnë marrëdhënie edhe me bashkëmoshatarët e tyre, me studentët që sapo diplomohen dhe me ish-studentë që kanë vetëm pak vite në tregun e punës.

Këta persona mund të jenë më të gatshëm të ofrojnë kohën e tyre dhe mund të japin informacione shumë praktike mbi mënyrën se si siguruan punën e parë, çfarë mjeteesh përdorën dhe çfarë funksionoi për ta.

Ata gjithashtu mund të krijojnë ura drejt profesionistëve më të lartë në hierarkinë e kompanisë, të cilët mund të jenë shumë më të vështirë për t'u kontaktuar drejtpërdrejt.

Dhe ka edhe një arsye tjetër për të mos nënvlerësuar kolegët që sot janë në fillimet e karrierës: hierarkitë ndryshojnë.

Personi që sot duket shumë i ri për t'ju ndihmuar mund të jetë drejtuesi juaj pas disa vitesh. Një marrëdhënie e krijuar herët mund të sjellë mundësi që sot është e pamundur t'i parashikoni.

3. Tregoni çfarë mund të ofroni edhe ju

Mungesa e vetëbesimit është një nga pengesat kryesore që të rinjtë hasin në krijimin e marrëdhënieve profesionale.

Sipas LinkedIn, 37% e Gjeneratës Z shqetësohen se mund t'i bezdisin të tjerët ose kanë frikë se do të gjykojnë kur përpiqen të krijojnë kontakte.

Një mënyrë për ta kapërcyer këtë pasiguri është të mos e shihni networking-un vetëm nga këndvështrimi i asaj që mund të merrni, por edhe të asaj që mund të jepni.

Në fillimet e karrierës mund të mos jeni në gjendje t'i ofroni dikujt një vend pune apo një mundësi biznesi. Por mund t'i ofroni informacion dhe njohuri.

Mund të jetë këndvështrimi juaj mbi një teknologji të re, një tendencë që sapo po shfaqet, një projekt ku keni punuar ose një ide që lidhet me punën e personit me të cilin dëshironi të krijoni marrëdhënie.

Njohuritë dhe ekspertiza që ndani mund të jenë pikërisht vlera që sillni në një marrëdhënie profesionale, edhe kur jeni në fillimet e karrierës.

4. Marrëdhëniet profesionale nuk ndërtohen brenda natës

Problemi tjetër është pritshmëria që networking-u të japë rezultate të menjëhershme, veçanërisht kur dikush po kërkon urgjentisht punë.

Por marrëdhëniet kërkojnë investim dhe kohë.

Ato nuk duhet të funksionojnë vetëm në një drejtim. Duhet të ketë shkëmbim, interes dhe gatishmëri për të dhënë diçka pa pritur domosdoshmërisht një përfitim të menjëhershëm.

Pikërisht për këtë arsye, rrjeti profesional nuk duhet të ndërtohet vetëm kur humbni punën apo kur po kërkon vendin e parë të punës.

Kontaktet duhen krijuar dhe kultivuar vazhdimisht: përmes postimeve, komenteve, ndërveprimeve dhe bisedave profesionale.

Ideja është e thjeshtë: lidhjet që mund t'ju hapin një derë pas pesë vitesh mund të jenë ato që filloni të ndërtoni sot.

Në një treg pune ku një kontakt brenda kompanisë mund t'i shumëfishojë shanset për t'u punësuar një kandidati, networking-u nuk është më thjesht një avantazh shtesë. Për Gjeneratën Z, aftësia për ta kthyer një "connection" në një marrëdhënie të vërtetë profesionale po bëhet një pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e vetë procesit të kërkimit të punës./Monitor

LAJME TË NGJASHME



Pse Gjenerata Z po shkojnë në intervista pune me prindërit?

1 MIN



"Nuk tërhiqem"/ Cristiano Ronaldo përgënjeshtrohet motrën e tij: Për të ardhmen vendos pas Botërorit

1 MIN



Si të shkruani një email që hap dyer të reja në karrierë!

5.5 MIN



Qesharake por këto sfida i pengojnë njerëzit nga ndërtimi i karrierës së tyre!

3 MIN



Përse Gjenerata Z po e 'braktis' jetën e natës?! Kjo është arsyeja...

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Lady Gaga bëhet nënë për herë të parë



Flasin ekspertët/Gërhitja e partnerit nuk është thjesht bezd, mund t'ju dëmtojë seriozisht shëndetin!



"Marshi për Liri" në mbështetje të ish-krerëve të UÇK, qytetarët nisin grumbullimin në Prishtinë



Para verdiktit, Kosova përcjell edhe njëherë mesazhin për ish-krerët e UÇK-së



Aksident në Selenicë, automjeti del nga rruga dhe bie nga një lartësi të madhe, humb jetën shoferi



Bëni kujdes me këto shenja të zodiakut/Për të flirtuar i keni 'ekspertë' por për lidhje serioze, harrojeni!



Ilaçi që mund të rikthejë flokët te personat me alopeci të rëndë...



Shenjat e zodiakut që luajnë "viktimitë" edhe kur kanë faj!



6-vjeçarja bëhet virale në rrjet, nis shkollën e vetme në fshatin me 40 banorë!



Daja para derbit me Partizanin: Do fitojë ekipi që do të bëjë më pak gabime, duhet të jemi gjithë kohës në ekuilibër!


EDITORI SUGJERON



Një dietologe tregon si të hani karbohidratet, proteinat, yndyrnat dhe fibrat për të kontrolluar...



Çfarë ndodh me trupin tuaj kur mermi ekstrakt çaji jeshil me kafeinë?!



Studim/Hemoglobina e ulët mund të çojë në...



Shumë njerëz e bëjnë çdo natë, por studimi i ri tregon një rrezik të fshehur!



Dëshironi të rregulloni kolesterolin?! Këto janë frutat që ju duhen...



Mendoni se po veproni mirë, por me këto ushqime po dëmtoni...




Kujdes! Këto ushqime nuk duhet t'i përzieni kurrë me vitaminën D...



Vaj ulliri me hudhër është i shëndetshëm për organizmin?! Ja se çfarë ndodh në të vërtetë...



Proteinat bimore apo proteinat shtazore?! Ja se cilat janë më të mira...



A duhet të stërviteni ndryshe gjatë menstruacioneve?! Përgjigjja mund t'ju befasojë...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontakti
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.